



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupština Glavnog Grada – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22.6.2023,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri dhe Mirsad Vitia.

Mungoi: Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Betim Abdullahu përfaqësues nga Zyra për komunitete.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina kryesues i komitetit, i cili paraqiti këtë

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 (KAB);
3. Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike;
4. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-430/01-0094474/17, dt. 24.4.2017;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
7. Propozimplanit lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës 2023-2026;

FaqeInga7

8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin "Llukar" në Prishtinë;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin "Busi" në Prishtinë;
10. Raport i punës për periudhën 1 janar -10 prill 2023, i ndërmarrjes publike "Sport Marketing", SHA;
11. Raport i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike "Stacioni i autobusëve", SHA;
12. Raport i punës për vitin 2022, i ndërmarrjes publike "Termokos", SHA;
13. Raport i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
14. Të ndryshme.

Para së të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës **Donjeta Dragusha** propozoi që pikat 11, 12 dhe 13 raportimet e ndërmarrjeve t'i largojmë prej rendit të ditës sepse aktualisht nuk kemi aksionarë legjitim nëpër ndërmarrje që do të mund të raportonin.

Valbona Makolli: - propozoi që të hyjë në rend dite **Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-400/01-69255/23, të dt. 3.4.2023 për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.**

Lulzim Fushtica: - propozoi që të hyjë në rend dite **Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një (1) qen, apo më shumë.**

Gëzim Sveçla: - tha mendoj që nuk bën ta prishim atë praktikën që pikat e reja në fillim të seancës i propozojmë dhe nëse në seancë hyn, në rregull është, ndërsa për propozimet që i bëri Donjeta, a duhet me i votuar të largohen nga rendi i ditës apo si është procedura.

Leutrim Retkoceri: - tha se në bazë të kërkesës, pavarësisht çfarë është, kërkesa duhet të jetë e mbështetur proceduralisht në rregullore. Rregullorja kërkon që për çdo pikë të rendit të ditës, hyrje apo largim, duhet të votojnë të gjithë anëtarët e KPF-së, pra proceduralisht duhet t'i nënshtrohet votimit nga anëtarët e komitetit për Politikë dhe Financa.

Gëzim Sveçla: - tha se i kemi në rend dite dy propozime për ndarjen e lokacioneve për çerdhe, por nuk është drejtoresha për t'i prezentuar këto.

Mimoza Sylejmani: - tha unë i prezantoj, përcaktimin e lokacioneve e bën Drejtoria e Planifikimit.

Nora Kelmendi: - tha Mimoza, ju po vini të prezantoni pikat në vend të Drejtoreshës së Arsimit, ju si drejtoreshë e planifikimit, a keni përgjigje për destinimin e parcelës që e keni shtyrë vendimin përpara, nuk keni përgjigje, kjo parcelë për çfarë është e destinuar. Ju kanë dërguar e-mail dhe nuk i jeni përgjigjur Drejtorisë së Arsimit.

Mimoza Sylejmani: - tha se me Planin zhvillimor aktual nuk janë të parapara, për këtë arsye ka ardhur edhe në Kuvend të caktohet ky lokacion.

Nora Kelmendi: - tha se pyetja ime është, pse nuk jeni përgjigjur.

Mimoza Sylejmani: - u përgjigj se është pronë komunale dhe për atë arsye ka ardhur në Kuvend, ka ardhur të votohet e të përcaktohet për çfarë.

Gëzim Sveçla: - tha propozojmë që të hidhet në votim që të tërhiqet si pikë e rendit të ditës pika e pestë - **Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit**, për shkak që arsyetimi që është bërë në këtë propozim nuk qëndron. Po ashtu propozojmë që të tërhiqet nga rendi i ditës pika e tetë - **Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Llukar” në Prishtinë** dhe pika e nëntë - **Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Busi” në Prishtinë**, për shkak që drejtoresha nuk është këtu të raportojë.

Doruntinë Maloku: - dha sqarime lidhur me pikën e pestë.

Gëzim Sveçla: - tha se Lagja “Kalabria” nuk ka plan rregullues dhe asnjë këmbim nuk mund të bëhet në Kalabri pa plan rregullues të lagjes, kështu që propozoj ta hedhim në votim.

Fehmi Kupina, kryesues: - tha se Propozimi i Donjetës ishte të tërhiqen pikët 10,11 dhe 12.

Kush është pro propozimit të Donjetës. Konstatohet se propozimet e Donjeta Dragushës kalojnë që të tërhiqen tri pika nga rendi i ditës.

Leutrim Retkoceri: - tha, kryesues pikat e rendit të ditës që sillen para Komitetit për Politikë dhe Financa propozohen, kanë materiale me vete, më e drejtë është të votohen e t’u shkojnë edhe asamblistëve të tjerë se sa pa materiale me shkuar në seancë e me hy aty për aty, kështu që unë propozoj të hedhet në votim sot, e marrim mbështetjen dhe kalon, nuk e marrim mbështetjen e provojmë prapë në seancë.

Fehmi Kupina, kryesues: - tha se pajtohem me juve sepse ashtu është, mirëpo është bërë një praktikë shumë e keqe që po i futin kështu në KPF, unë për vete jam kundër.

Leutrim Retkoceri: - tha, kryesues, praktikat po i shohim, por kanë ndryshuar gjërat kështu që vendoseni në votim siç e parasheh rregullorja.

Fehmi Kupina, kryesues: - e hodhi në votimin propozimin e Valbona Makollit

- **Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-400/01-69255/23, të dt. 3.4.2023 për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.**

Me 6 vota kundër nuk hyn në rend dite kjo pikë në KPF, mbetet të propozohet në Kuvend.

Po ashtu kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Lulzim Fushticës,

- **Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një (1) qen, apo më shumë.**

Me 6 vota kundër nuk hyn në rend kjo pikë në KPF, mbetet të propozohet në Kuvend.

Po ashtu tha Gëzimi kërkon me u tërhiq pika e pestë nga rendi i ditës.

-**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit.**

Në fund kryesuesi kërkoi nga anëtari Sveçla, nëse ka mundësi që para se të merret ky vendim edhe njëherë të arsyetohet kjo.

Gëzim Sveçla: - dha sqarime se propozimi që ka ardhur nga drejtorja mbështetet në Planin rregullues për lagjen “Kalabria”. Lagja “Kalabria” nuk ka Plan rregullues, nuk ka mundësi të ndërtohet asgjë në “Kalabri” sepse “Kalabria” nuk ka Plan rregullues.

Doruntinë Maloku: - kërkoi të japë arsyetimin e saj për këtë pikë.

Fehmi Kupina, kryesuesi: - e hodhi në votim pikën e pestë se kush është për tërheqjen e kësaj pike. Me 6 vota pro, u tërhoq kjo pikë nga rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e tetë dhe pikën e nëntë për propozimet e Gëzimit që të tërhoqen nga rendi i ditës.

Osman Bllaca: - tha se këto dy pikat 8 dhe 9 po vijnë nga Drejtoria e Planifikimit.

Nora Kelmendi: - tha se nëse lokacionet vijnë nga Drejtoria e Planifikimit, atëherë deri para seancës le të na i dërgojnë skicat e lokacionit për Busi e Llukar, se nuk i keni skicat e lokacionit.

Luljeta Selimi, shefe e Shërbimit të Kuvendit të Kryeqytetit: - dha sqarime se materialin komplet e ka përcjellë të njëjtë si për Komitetin për Politikë e Financa ashtu edhe për Kuvend.

Gëzim Sveçla: - tha se kush është propozues i pikës së katërt të rendit të ditës.

-Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-430/01-0094474/17, dt. 24.4.2017.

Nora Kelmendi: - tha se Drejtori i Urbanizmit.

Gëzim Sveçla: - nuk është këtu ta prezentojë pikën, unë po propozoj të tërhoqet edhe pika e katërt.

Fehmi Kupina, kryesuesi: - e hodhi në votim pikën e katërt se kush është për tërheqjen e kësaj pike.

Me 6 vota pro, tërhoqet edhe kjo pikë nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 (KAB);
3. Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
5. Propozimplani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2023-2026;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin "Llukar" në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin "Busi" në Prishtinë;
8. Raport i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së katërt i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me Propozimplanin lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës 2023-2026, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Betim Abdullahu**, përfaqësues nga Zyra për komunitete.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimplanin lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës 2023-2026 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Llukar” në Prishtinë.

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Llukar” në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Mimoza Sylejmani**, drejtore. Pasi në fshatra nuk ka plane rregulluese, me kërkesë së Ministrisë së Arsimit, drejtuar Drejtorisë së Arsimit, kanë kërkuar të kemi 7 lokacione nëpër fshatra. Ky lokacioni që po e shihni në Llukar, është me destinim ndërtim individual dhe propozojmë të bëhet një institucion parashkollor dhe sipas kërkesës është 38 ari ku 25 i kemi dedikuar për çerdhe.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Llukar” në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Busi” në Prishtinë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Busi” në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Mimoza Sylejmani**, drejtore. Njësoj vlen edhe për fshatin Busi, sipas Planit zhvillimor komunal aktual, destinimi është për banim individual, ne i kemi ndarë 40 ari për çerdhe, kështu që e njëjta vlen. Nëse do t'i kishte përcaktuar Plani rregullues, atëherë nuk do të kishim ardhur në Kuvend fare, do të shkonim direkt në Ministri të Arsimit dhe do të fillonim me procedurat.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin “Busi” në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Raport i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Lidhur me Raportin e punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Lulzim Fushtica**, drejtor.

Siç është e paraparë edhe në udhëzimin administrativ 02.2012 dhe 07.2012 të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është i obliguar që të raportojë para Kuvendit Komunal dhe të paraqesë raportin e punës për vitin paraprak. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është i domosdoshëm dhe çdo komunë është e obliguar që ta themelojë dhe të mbahen së paku gjashtë takime në vit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Gëzim Sveçla: - pyeti për disa vendime të seancës së 8 qershorit, të cilat nuk janë publikuar në web-faqe të Komunës, a ka ndonjë sqarim.

Fehmi Kupina, kryesues: - tha unë i kam përcjell, mund ta pyesim znj. Luljeta.

Luljeta Selimi, shefe e Shërbimit të Kuvendit të Kryeqytetit: - dha sqarime se Kabineti i Kryetarit i ka njoftuar se kanë bërë kërkesë në ministri dhe po presim përgjigje.

Gëzim Sveçla: - tha se është çështje e legjislativit, Kuvendi i ka kompetencat e ndara, nëse nuk publikohen, cila është esenca që mbajmë mbledhje të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

**Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit
Pëllumb Bajqirovi**

